Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/507
Datë: 05.08.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë nr. 09/2019, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.08.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "Gutenberg Academy", me adresë: Rruga Prekazi- Objekti CIMA, në Komunën e Prishtinës, Republika e Kosovës, për periudhën dy (2) vjeçare, përkatësisht nga data 05.08.2022 deri 04.08.2024, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këto kualifikime:

   1.1 **Kurse të Gjuhës Gjermane, niveli A1 deri në C1,** institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit deri në pesëmbëdhjetë (15) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në 24 grupe.

   1.2 **Kurse Të Gjuhës Angleze, niveli A1 deri në C1,** institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit deri në pesëmbëdhjetë (15) kandidatë brenda një grupi dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në 28 grupe.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Gutenberg Academy", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si

institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit, Gutenberg Academy, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK